

# Republika e Shqipërisë

## Nisma e Transparencës për Industritë Nxjerrëse



## Raporti NTIN (EITI) 2010



42 Avenue Montaigne  
75008 Paris - FRANCE

-  
1 Heddon Street  
London W1B1BD - UK

Ky raport është përkthyer në shqip nga gjuha angleze. Nëse lindin mospërputhje midis dy versioneve duhet të merrni parasysh versionin në anglisht, si versionin e gjuhës së shkruar në original.





Nisma për Transparencë në Industrinë Nxjerrëse në Shqipëri (ALBEITI)

Tiranë – SHQIPËRI

Paris, më 21 dhjetor 2012

*Drejtuar Presidentit të Grupit të Punës ALBEITI*

Subjekti: Raporti EITI për Shqipërinë 2010

Nisma e Transparencës së Industrive Nxjerrëse ( EITI) synon që të rrisë transparencën dhe qeverisjen në menaxhimin e të ardhurave publike të krijuara nga sektorët nxjerrës (naftë, gaz dhe sektori minerar). Republika e Shqipërisë u angazhua për zbatimin e EITI-it qysh në muajin mars 2009 dhe u bë vend kandidat në muajin maj 2009.

Grupi i Punës ALBEITI është organi vendimmarrës i ngarkuar për mbikëqyrjen e zbatimit të EITI-it në Shqipëri. Ky grup i rregulluar sipas udhëzimit publik me nr. 71, datë 21 korrik 2011 drejtohet nga Ministri i Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës dhe është i përbërë nga aktorë të ndryshëm të EITI-t (qeveria, kompanitë nxjerrëse, shoqëria civile). Grupi punës ALBEITI mbështetet në punën e vet nga Sekretariati Shqiptar i Nismës së Transparencës në Industrinë Nxjerrëse ALBEITI.

Në kuadër të zbatimit të vazhdueshëm të raportit EITI në Shqipëri, kompania *Fair Links* u përzgjedh në muajin mars 2012, nëpërmjet procedurave të tenderit ndërkombëtar, si administrator i pavarur i ngarkuar për hartimin e raportit të dytë EITI për Shqipërinë për vitin 2010.

Ky Raport EITI 2010 synon të përmirësojë arsyetimin/të kuptuarit tonë lidhur me kontributin që japin kompanitë nxjerrëse në zhvillimin ekonomik dhe social të Shqipërisë.

Në këtë drejtim, puna jonë si administrator i pavarur ka konsistuar në mbledhjen, rakordimin dhe përpilimin e:

- Të ardhurave fiskale të deklaruara dhe të vjela nga shteti nga kompanitë nxjerrëse për vitin 2010;
- Pagesave fiskale të deklaruara nga këto kompani nxjerrëse që i janë bërë shtetit shqiptar në vitin 2010.

Ky raport është shkruar në përputhje të plotë me praktikën më të mira ndërkombëtare për raportimin EITI. Puna jonë është bazuar në standardet ndërkombëtare për shërbime të përafërta si këto (ISRS- International Standards on Related Services) tashmë të botuara nga Federata Ndërkombëtare e Kontabilistëve (IFAC (International Federation of Accountants): ISRS 4400, në lidhje me "angazhimin për realizimin e procedurave të miratuara lidhur me informacionin financiar" dhe ISRS 4410 lidhur me "angazhimin për përpilimin e informacionit financiar". Praktika të tilla në mënyrë të veçantë kërkojnë një shkallë të lartë integriteti, respektim të etikës, si dhe një zbatim rigoroz të procedurave të hartuara për sigurimin e cilësisë, përshtatshmërisë dhe paanshmërisë së punës sonë, qofshin këto procedura që lidhen me menaxhimin e punës, menaxhimin e burimeve, apo të kontrolleve të brendshme.

Ky Raport, i hartuar për përdorim ekskluziv nga grupi i punës ALBEITI, parashtron si më poshtë:

1. Një përmbledhje të shkurtër të sektorit nxjerrës në Shqipëri;
2. Numrin e kompanive dhe burimet e ardhurave (*benefit stream*) të përzgjedhura për Raportin EITI 2010;
3. Natyrën dhe nivelin e punës sonë si administrator i pavarur;
4. Rakordimin përfundimtar të të dhënave për sektorët e naftës, të gazit dhe sektorit të minierave;
5. Komentet dhe rekomandimet tona kryesore.

Fair Links

A handwritten signature in blue ink that reads "Fair Links".

Anton Mélard de Feuarent

## Përmbledhje e shkurtër

Ky raport EITI paraqet rakordimin e të ardhurave fiskale të deklaruara, që rezultojnë të mbledhura nga shteti shqiptar, prej kompanive nxjerrëse (naftë, gaz dhe sektori i minierave) si dhe pagesat e deklaruara dhe të kryera nga këto kompani nxjerrëse për vitin 2010.

Të dhënat e paraqitura për sektorin e naftës dhe të gazit janë bazuar në deklaratat e marra nga 8 kompani që kanë dorëzuar deklaratat e plota EITI. Këto deklarata përfshijnë, përveç 5 burimeve të të ardhurave (*benefit streams*) të përzgjedhura nga grupi i punës ALBEITI, çdo pagesë tjetër që tejkalon 50 mijë USD (5 milionë Lekë) që i është bërë shtetit shqiptar si dhe çdo pagesë mbi 5 mijë USD (500 mijë Lek) që i është bërë autoriteteve lokale. Këto deklarata janë vërtetuar nga auditorët e jashtëm të kompanive deklaruuese duke garantuar kështu besueshmërinë dhe gjithëpërfshirjen e të dhënave të paraqitura për sektorin e naftës dhe të gazit. Kompania Sky Petroleum, e vetmja kompani e naftës dhe gazit, që nuk ka dorëzuar deklaratat EITI, po kalon procedurën e arbitrazhit me shtetin shqiptar. Kompania Sky Petroleum ishte përfshirë në fushën e eksplorimeve në vitin 2010 dhe për këtë arsye nuk ka gjasa t'i ketë paguar ndonjë të ardhur të rëndësishme shtetit shqiptar. Ndaj mund të nxjerrim përfundime bindëse se rakordimi i të dhënave të paraqitura më poshtë pasqyron kontributin efektiv fiskal të sektorit të naftës dhe të gazit kundrejt të ardhurave të shtetit në vitin 2010.

(USD)	2010				
	Të dhënat e deklaruara			Δ Kompanitë - Shtet	Δ Kompanitë - Albpetrol
	Kompanitë	Albpetrol (kompanitë)	Shtet		
1. Bonuset e nënshkrimit	400 000		400 000	-	
2. Renta minerare (nga kompanitë private)	18 499 298		18 801 781	(302 483)	
2. Renta minerare (nga Albpetrol)		7 655 487	8 805 469	(1 149 982)	
3. Pjesa nga ndarja e prodhimit që i shkon Kompanisë Kombëtare të Naftës	24 474 090	24 463 090			11 000
4. Tatimi mbi fitimin (nga kompanitë private)	-		-	-	-
4. Tatimi mbi fitimin (nga Albpetrol)		2 644 811	2 415 480	229 331	
5. Dividentët					
6. Pagesa të tjera të rëndësishme që i bëhen shtetit (nga kompanitë private)	100 000		100 000		
6. Pagesa të tjera të rëndësishme që i bëhen shtetit (nga Albpetrol)		1 849 455	1 860 013	(10 558)	
7. Pagesa të tjera tek pushteti vendor (nga kompanitë private)	-		-	-	-
7. Pagesa të tjera tek pushteti vendor (nga Albpetrol)					
<b>Total (USD)</b>	<b>43 473 388</b>		<b>32 382 743</b>	<b>(1 233 692)</b>	<b>11 000</b>

Të dhënat e paraqitura për sektorin minerar janë bazuar në deklaratat e marra nga 54 kompani që kanë dorëzuar deklaratat e plota EITI. Sa i takon sektorit të naftës dhe të gazit këto deklarata përfshijnë, përveç të ardhurave të mbledhura nga shteti, tashmë të përzgjedhura nga grupi i punës ALBEITI, çdo pagesë tjetër mbi 50 mijë USD (5 Milionë Lekë) të kryer për shtetin si dhe çdo pagesë mbi 5 mijë USD (500,000 Lek) të kryer për autoritetet lokale. Deklaratat e marra nga kompanitë e mëdha minerare me aftësi prodhuese janë vërtetuar nga auditorët e tyre të jashtëm, pra ato garantojnë besueshmërinë dhe gjithëpërfshirjen e të dhënave që kanë paraqitur. Gjashtë kompanitë minerare, që nuk kanë dorëzuar deklaratat EITI, ose ishin të përfshira në aktivitet eksplorimi, ose ishin me përmasa të kufizuara. Në të dyja rastet nuk ka gjasa që kontributi i tyre fiskal të ketë qenë i rëndësishëm. Prandaj mund të nxjerrim përfundime të arsyeshme se rakordimi i të dhënave të paraqitura më poshtë pasqyron kontributin efektiv fiskal në të ardhura që sektori minerar i ka kryer shtetit në vitin 2010.

(Leks)	2010		
	Të dhënat e deklaruara		Variacion
	Kompanitë	Shtet	
1. Bonuset e nënshkrimit	1 982 902	2 982 792	(999 890)
2. Taksat për sipërfaqen	29 698 393	22 201 355	7 497 038
3. Renta minerare	282 413 274	290 739 932	(8 326 658)
4. Tatimi mbi fitimin	218 171 239	215 084 788	3 086 451
5. Pagesa të tjera të rëndësishme që i bëhen shtetit	73 694 676	73 694 676	-
6. Pagesa të tjera tek pushteti vendor	6 893 906	5 640 640	1 253 266
<b>Total (Leks)</b>	<b>612 854 390</b>	<b>610 344 183</b>	<b>2 510 207</b>

Ne kemi formuluar komentet dhe rekomandimet lidhur me cilësinë e procesit ALBEITI. Këto komente dhe rekomandime mund të gjenden në pjesën e fundit të këtij Raporti. Ato mund të merren parasysh në mënyrë që të reflektohen në Raportin EITI 2010.

# Tabela e Permbajtjes

<b>Letra e paraqitjes se Raportit</b>	<b>2</b>
<b>Përmbledhje e shkurtër</b>	<b>4</b>
<b>1. Një paraqitje e sektorit nxjerrës në Shqipëri</b>	<b>7</b>
<b>1.1. Sektori i naftës dhe i gazit</b>	<b>7</b>
1.1.1. Potenciali i sektorit të gazit dhe naftës	7
1.1.2. Korniza institucionale e sektorit të gazit dhe të naftës	7
1.1.3. Aktorët privatë të sektorit të naftës dhe të gazit	8
<b>1.2. Sektori mineral</b>	<b>8</b>
1.2.1. Potencialet e sektorit mineral	8
1.2.2. Korniza institucionale e sektorit mineral	8
1.2.3. Aktorët privatë në sektorin mineral	8
<b>2. Kompanitë dhe të ardhurat e mbledhura nga shteti të përzgjedhura nga Raporti EITI 2010</b>	<b>10</b>
<b>2.1. Sektori i naftës dhe i gazit</b>	<b>10</b>
2.1.1. Kompanitë	10
2.1.2. Të ardhurat e mbledhura nga shteti ( <i>Benefit streams</i> )	10
<b>2.2. Sektori mineral</b>	<b>11</b>
2.2.1. Kompanitë	11
2.2.2. Të ardhurat e vjela nga shteti ( <i>benefit streams</i> )	11
<b>2.3. Dokumentet standarde të raportimit të përdorura në raport</b>	<b>12</b>
<b>3. Natyra dhe shtrirja e punës sonë si administrator i pavarur</b>	<b>13</b>
<b>4. Rakordimi përfundimtar i të dhënave për sektorët e naftës, gazit dhe atë mineral</b>	<b>14</b>
4.1. Sektori i naftës dhe i gazit	14
4.2. Sektori mineral	15
4.3. Konkluzionet kryesore	17
<b>5. Komentet dhe rekomandimet kryesore</b>	<b>18</b>
5.1. Përkufizimi mbi objektivat e përdorur	18
5.2. Rritja e aksesit ndaj të dhënave	18
5.3. Shqyrtimi i deklaratave nga autoritet vendore	19
5.4. Evoluimi i objektivave të raporteve të ardhshme EITI	19

# Lista e shkurtesave

## Agjenci shtetërore

AKBN	Agjencia Kombëtare e Burimeve Natyrore
METE	Ministria e Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës

## Sektori Nxjerrës

Kg	Kilogram
M <sup>3</sup>	Metra kub
Cf	Kub këmbë (feet)
Mcf	Miliona kub këmbë (feet)
PSA	Marrëveshja për ndarjen e prodhimit

## Të tjera

ALBEITI	Nisma e Transparencës së Industrive Nxjerrëse në Shqipëri
KUSD	Mijë dollarë amerikanë
MUSD	Milionë dollarë amerikanë
KLeks	mijë lekë
MLeks	milionë lekë

## 1. Një paraqitje e sektorit nxjerrës në Shqipëri

Informacioni i paraqitur më poshtë në formën e një përshkrimi të sektorit nxjerrës në Shqipëri është mbledhur nga burime të ndryshme, të identifikuar si të besueshme, megjithatë, ne nuk kemi testuar saktësinë e këtyre të dhënave.

### 1.1. Sektori i naftës dhe i gazit

#### 1.1.1. Potenciali i sektorit të gazit dhe naftës

Rezervat e provuara dhe të mundshme të naftës në Shqipëri vlerësohen në rreth 277 milionë fuçi<sup>1</sup>. Në vitin 2010 prodhimi ditor i naftës bruto / të papërpunuar ishte rreth 15,000 fuçi<sup>2</sup>. Ky prodhim është nxjerrë kryesisht nga (i) zona naftëmbajtëse Patos Marinzë-Kolonjë (82% e prodhimit), e njohur si zona naftëmbajtëse më e madhe në Europën kontinentale, (ii) zona naftëmbajtëse Gorisht-Kocul (6% e prodhimit) dhe (iii) zona naftëmbajtëse e Kuçovës (3% e prodhimit)<sup>3</sup>.

Rezervat e provuara dhe të mundshme të gazit janë vlerësuar në 791 miliardë kub këmbë (feet)<sup>4</sup>. Prodhimi ditor i gazit natyror është mesatarisht 1,4 milionë kub këmbë (feet)<sup>5</sup>. Ky prodhim është marrë kryesisht nga zona naftëmbajtëse Patos-Marinzë-Kolonjë (61% e prodhimit vjetor), në zonën Cakran-Mollaj (10%) dhe në zonën e Kuçovës (4%)<sup>6</sup>.

Ky prodhim i naftës dhe gazit gjeneron (sjell) të ardhura të kufizuara fiskale për Shtetin Shqiptar. Në të vërtetë, në vitin 2009, kontributi fiskal i sektorit të naftës dhe gazit ka qenë më pak se 1% e të ardhurave totale fiskale të mbledhura nga Shteti Shqiptar<sup>7</sup>.

#### 1.1.2. Korniza institucionale e sektorit të gazit dhe të naftës

Kërkimi, zhvillimi dhe prodhimi i hidrokarbureve në Shqipëri është i rregulluar me ligjin nr. 7746 'mbi naftën' (kërkimi dhe prodhimi) i datës 28 korrik 1993 si dhe udhëzimi nr. 782 'mbi sistemin fiskal në sektorin e naftës (kërkim-prodhim) i datës 22 shkurt 1994. Qysh nga miratimi i ligjit, janë kryer disa amendamente me ligjet nr. 7853 (29 korrik 1994), 7811 (12 prill 1994) dhe 9975 (28 korrik 2008)<sup>8</sup>. Ministria e Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës (METE) është përgjegjëse për respektimin dhe zbatimin e këtij legjislacioni.

Marrëveshjet e naftës janë hartuar të gjitha si Marrëveshje për Ndarjen e Prodhimit (PSA), të nënshkuara nga Agjencia Kombëtare e Burimeve Natyrore (AKBN) në emër të shtetit<sup>9</sup>. Sipas kontratave të tilla dhe në pajtim me Ligjin nr. 7746 'mbi naftën' (kërkim dhe prodhim), një "Marrëveshje për ndarjen e prodhimit do të thotë një marrëveshje për naftën e cila rikuperon kostot e kontratave nga nafta e prodhuar në zonën ku vepron kontrata ose nga një pjesë proporcionale e saj dhe për ndarjen e bilancit të naftës që mbetet pas rikuperimit të kostove të kontratës midis shtetit dhe kontraktorit në përputhje me një shkallë apo formulë të përcaktuar në marrëveshjen e naftës"<sup>10</sup>.

Albpetrol Sh. A. ("Albpetrol") është kompania shqiptare shtetërore e naftës, ku shteti është aksionari i vetëm i saj. Albpetrol mban aksione në çdo marrëveshje të nënshkuar në Shqipëri në emër të shtetit shqiptar. Albpetrol gjithashtu operon ekskluzivisht në zona naftëmbajtëse si në atë të Amonicës dhe në zonat

gazmbajtëse si në Divjakë, Ballaj-Kryevidh, Frakull dhe Panaja<sup>11</sup>. Sipas Ligjit nr. 10490, datë 15 dhjetor 2011, Kuvendi i Shqipërisë ka vendosur që Albpetrol të privatizohet.

<sup>1</sup> Raporti GEPS për Shqipërinë, IHS, janar 2012

<sup>2</sup> Informacion mbi prodhimin e naftës dhe të gazit për vitin, AKBN, qershor 2012

<sup>3</sup> Raporti GEPS për Shqipërinë, IHS, janar 2012

<sup>4</sup> Id.

<sup>5</sup> Raporti GEPS për Shqipërinë, IHS, janar 2012

<sup>6</sup> Id.

<sup>7</sup> Kuptojmë se të ardhurat fiskale në total për shtetin shqiptar arritën në 2.9 miliardë USD (288.8 miliardë Lek) në vitin 2010, siç gjendet tek botimi *Shqipëria: Artikulli IV konsultatime 2011 – Staff Report*, FMN, tetor 2011

<sup>8</sup> *Permbledhje e kornizes ligjore shqiptare për eksplorimin dhe prodhimin e naftës* – [www.akbn.gov.al](http://www.akbn.gov.al)

<sup>9</sup> *Investo në burimet natyrore shqiptare*, Agjencia Kombëtare e Burimeve Natyrore, (AKBN) – [www.akbn.gov.al](http://www.akbn.gov.al)

<sup>10</sup> *Ligji nr. 7746 për naftën* (Zbulim dhe Prodhim), Neni 2

<sup>11</sup> Id.

### 1.1.3. Aktorët privatë të sektorit të naftës dhe të gazit

Dy kompani ndërkombëtare të naftës dhe gazit kishin licenca prodhimi në vitin 2010:

- Bankers Petroleum, që operon në zonat naftë mbajtëse të Patos-Marinzës dhe Kuçovës<sup>12</sup>;
- Stream Oil & Gas, që operon në Gorisht-Kocul, Cakran-Mollaj dhe zonën naftëmbajtëse Delvinë<sup>13</sup>.

Në vitin 2010, disa licenca të njëpasnjëshme për zbulim u mbajtën nga IEC Visoka, Sky Petroleum, Manas Adriatik, Sherwood International (brenda territorit), Capricon dhe Island International (det të hapur)<sup>14</sup>.

## 1.2. Sektori minerar

### 1.2.1. Potencialet e sektorit minerar

Shqipëria ka pasur një histori të gjatë në sektorin e minierave me vendburime të mëdha minerale: kromi, nikeli, bakri dhe guri gëlqeror. Rezervat e kromit janë vlerësuar afërsisht me 37 milionë ton<sup>15</sup>, rezervat e bakrit në rreth 30 milionë ton<sup>16</sup> dhe rezervat e xeherorit të nikelit në gati 300 milionë ton<sup>17</sup>.

Rezulton se më shumë se 800 leje janë dhënë për kërkim, zbulim dhe nxjerrje (shfrytëzim), nga të cilat rreth 700 janë dhënë për prodhim<sup>18</sup>. Kromi dhe gurët gëlqerorë janë mineralet më tërheqëse në Shqipëri, ku secili numëron më shumë se 250 leje<sup>19</sup>.

Në vitin 2010, prodhimi kombëtar i kromit i tejkaloi 330,000 ton ndërsa prodhimi i gurit gëlqeror arriti mesatarisht 2.3 milionë m<sup>3</sup>. Prodhimi i bakrit ishte afërsisht 140,000 ton dhe prodhimi i nikelit në 270,000 ton<sup>20</sup>.

Profili i sektorit të minierave shqiptare - shumë prodhues të vegjël e të shpërndarë në të gjithë vendin – kjo shpjegon pjesërisht kontributin shumë të vogël të këtij sektori në të ardhurat e vendit. Në vitin 2009 të ardhurat e mbledhura nga sektori minerar ishin më pak se 1.8 milionë USD (186 milionë lek), vetëm 0.07% e të ardhurave fiskale totale të mbledhura nga shteti<sup>21</sup>.

### 1.2.2. Korniza institucionale e sektorit minerar

Sektori minerar në Shqipëri është rregulluar me Ligjin nr. 10304 për sektorin e minierave në Republikën e Shqipërisë i datës 15 korrik 2010, i cili hyri në fuqi në gusht të vitit 2010 dhe u shfuqizua me Ligjin minerar nr. 7796 të datës 17 shkurt 1994. METE, nëpërmjet AKBN-së, është përgjegjës për respektimin dhe zbatimin e këtij legjislacioni. Konstatohet se në bazë të nenit 36, ky ligj në mënyrë eksplicite (të qartë) detyron kompanitë minerare, që operojnë në Shqipëri të bëjnë publike pagesat e tyre tatimore në përputhje me Nismën e Transparencës së Industrive Nxjerrëse.

### 1.2.3. Aktorët privatë në sektorin minerar

Si një vend tradicional minerar, Shqipëria numëron një numër kompanish të mesme dhe të vogla shfrytëzimi (nentoksore) e kompani karrjerash (gurore) dhe vetëm dy-tri kompani të mëdha minerare-industriale.

Kompania “Kromi Shqiptar-ACR”, që ushtron aktivitetin nxjerrës në minierën e Bulqizës, ishte e vetmja kompani industriale nxjerrëse e kromit në Shqipëri në vitin 2010. DCM, kompania mëmë e ACR-së, po planifikon të investojë 15 milionë € m në të ardhmen e afërt me synim rritjen e kapacitetit vjetor të prodhimit të minierës së Bulqizës nga 80,000 ton sot në 100,000 ton<sup>22</sup>. Shumë kompani të mesme dhe të vogla (më shumë se 250

<sup>12</sup> Bankers Petroleum website: [www.bankerspetroleum.com](http://www.bankerspetroleum.com)

<sup>13</sup> Stream Oil & Gas website: [www.streamoilandgas.com](http://www.streamoilandgas.com)

<sup>14</sup> Gjendja e licensave të eksplorimit/kërkimit dhe situata aktuale e lincensimi, Agjencia Kombëtare e Burimeve Natyrore (AKBN) – [www.akbn.gov.al](http://www.akbn.gov.al)

<sup>15</sup> Investo në burimet natyrore shqiptare, Agjencia Kombëtare e Burimeve Natyrore (AKBN) – [www.akbn.gov.al](http://www.akbn.gov.al)

<sup>16</sup> Id.

<sup>17</sup> Websiti i sekretariatit ALBEITI: [www.albeiti.org](http://www.albeiti.org)

<sup>18</sup> Investo në burimet natyrore shqiptare, Agjencia Kombëtare e Burimeve Natyrore (AKBN) website: [www.akbn.gov.al](http://www.akbn.gov.al)

<sup>19</sup> Id.

<sup>20</sup> Për të gjitha shifrat, Të dhënat kryesore të sektorit minerar shqiptar dhe të prodhimit të industrive përpunuese, Agjencia Kombëtare e Burimeve Natyrore (AKBN)

<sup>21</sup> Kuptohet se të ardhurat fiskale në total për shtetin shqiptar arritën në 2.9 miliardë USD (288.8 miliardë Lek) në vitin 2010, siç gjendet tek botimi *Shqipëria: Artikulli IV konsultatime 2011 – Staff Report*, FMN, tetor 2011

<sup>22</sup> DCM website: [www.dcm-vienna.com](http://www.dcm-vienna.com)



licenca) nxirrnin krom në masivët ultrabazikë të Tropojës dhe Kukësit, në masivin ultrabazik të Bulqizës dhe në masivet ultrabazikë të Shebenik-Pogradecit<sup>23</sup>.

Beralb ishte e vetmja kompani industriale nxjerrëse e bakrit në vitin 2010. Beralb zotëron licenca prodhimi të mineralit të bakrit në minierat e Munelles, Lak Roshit, Karmës dhe të përpunimit të mineralit në fabriken e pasurimit të Fush Arrëzit, të gjitha të vendosura në krahinën e Pukës<sup>24</sup>. Asnjë kompani e mesme apo e vogël minerare nuk nxirrte bakër në vitin 2010.

Nikeli nxirret kryesisht në formën e mineralit të hekur-nikelit dhe nikelit-silikat në rajonet e Devollit, Pogradecit, Librazhdit dhe Kukësit<sup>25</sup>. Mesa jemi informuar vetëm kompanitë e mesme dhe të vogla nxirrnin këtë mineral në vitin 2010.

Guri gëlqeror, i përdorur kryesisht për prodhimin e çimentos, apo si një material ndertimi apo dekorativ ndërtimor gjendet në gjithë territorin e Shqipërisë. Kjo shpjegon edhe numrin e madh të operatorëve shumë të vegjël për këtë mineral, të shpërndarë në të gjithë vendin.

---

<sup>23</sup> *Investo në burimet natyrore shqiptare*, Agjencia Kombëtare e Burimeve Natyrore (AKBN) – [www.akbn.gov.al](http://www.akbn.gov.al)

<sup>24</sup> Beralb website: [www.beralb.com](http://www.beralb.com)

<sup>25</sup> *Investo në burimet natyrore shqiptare*, Agjencia Kombëtare e Burimeve Natyrore (AKBN) – [www.akbn.gov.al](http://www.akbn.gov.al)

## 2. Kompanitë dhe të ardhurat e mbledhura nga shteti të përzgjedhura nga Raporti EITI 2010

Raporti EITI 2010 përkufizon:

- Kompanitë nxjerrëse që u është kërkuar të deklarojnë pagesat e tyre ndaj shtetit;
- Llojet e ndryshme të pagesave (përfitimet e vjela) që merren parasysh në deklaratat e tyre.

Ky objektivi është përcaktuar nga grupi i punës ALBEITI, i cili mban përgjegjësi për të. Ky objektivi u diskutua në praninë tonë në Tiranë në muajin prill 2012.

### 2.1. Sektori i naftës dhe i gazit

#### 2.1.1. Kompanitë

Grupi i punës ALBEITI ka vendosur që ky raport EITI të marrë parasysh të gjitha kompanitë e naftës dhe të gazit që operojnë në Shqipëri në vitin 2010, përfshirë kompanitë shtetërore ose ato private, kompanitë në prodhimin apo në zbulim.


Kjo qasje ka çuar në përzgjedhjen e 9 kompanive të naftës dhe të gazit: 1 shtetërore dhe 8 kompani private, ndër të cilat, 3 kompani në prodhim (përfshirë Albpetrol) dhe 6 në eksplorim<sup>26</sup>.

#### 2.1.2. Të ardhurat e mbledhura nga shteti (*Benefit streams*)

Grupi i punës ALBEITI ka vendosur që ky raport EITI të marrë parasysh 4 llojet të veçanta të taksave për naftën e gazin, ashtu siç përcaktohen në Ligjin Minerar Shqiptar<sup>27</sup>, si dhe tatim fitimin e kompanisë.

Për të siguruar përfshirje të plote të kompanive, grupi i punës ALBEITI ka vendosur që: "të ardhura të tjera të rëndësishme / pagesa që kalojnë për shtetin" (me një prag të caktuar pagese (*ang. materiality threshold*) në 50 mijë USD [5 milionë lek]<sup>28</sup> në vit për kompani) dhe "të ardhurat e tjera të rëndësishme / pagesa për autoritetet lokale" (me një prag (*kufi*) të caktuar pagesash (*materiality threshold*) në 5 mijë USD [500 mijë Lek]<sup>29</sup> në vit, për kompani), duhet të deklarohen gjithashtu nga agjencitë shtetërore dhe kompanitë nxjerrëse.

7 llojet e të ardhurave të mbledhura nga shteti, të përzgjedhura nga sektori i naftës dhe gazit për raportin EITI 2010, mund të ilustrohen si më poshtë vijon:<sup>30</sup>



Të ardhurat e mbledhura nga shteti nga sektori i naftës dhe i gazit të marra parasysh në raportin EITI 2010

<sup>26</sup> Lista e plotë e kompanive të naftës dhe të gazit të përzgjedhura për raportin ALBEITI 2010 mund të gjenden në shtojcën nr. 1.

<sup>27</sup> *Ligji minerar shqiptar nr. 10304*, 15 korrik 2010

<sup>28</sup> Ose 0,2% e kontributit fiskal të sektorit nxjerrës të publikuar në raportin EITI 2009

<sup>29</sup> Ose 0,2% e kontributit fiskal të sektorit nxjerrës të publikuar në raportin EITI 2009

<sup>30</sup> Lista e plotë e burimit të të ardhurave dhe përshkrimet e tyre mund të gjenden në shtojcën nr. 2

## 2.2. Sektori minerar

### 2.2.1. Kompanitë

#### 2.2.1.1. Sektori minerar i madh

Grupi punës ALBEITI ka vendosur që ky raport të marrë parasysht të gjitha kompanitë industriale minerare të mëdha që operojnë në Shqipëri në vitin 2010, qofshin kompani të përfshira në prodhim apo në **zbulim**.

Kjo qasje ka çuar në përzgjedhjen e 7 kompanive të mëdha minerar, 2 në prodhim (të shfrytëzimit) dhe 5 në eksplorim (zbulim)<sup>31</sup>.

#### 2.2.1.2. Sektori i minierave të mesme dhe të vogla dhe i karrjerave (guroreve)

Duke pasur parasysht numrin shumë të madh të aktorëve të mesëm dhe të vegjël të karrjerave (guroreve) që operojnë në të gjithë Shqipërinë, grupi i punës ALBEITI ka vendosur t'i marrë kompanitë në shqyrtim bazuar në nivelin e tyre të mundshëm të kontributit me të ardhura shtetërore. Pra, kjo përzgjedhje është kufizuar në ato kompani me një qarkullim vjetor<sup>32</sup> prej më shumë se 500 mijë USD (50 milionë Lek)<sup>33</sup>.


Kjo qasje ka çuar në një përzgjedhje ambicioze të 38 kompanive minerare të mesme dhe të vogla dhe të 15 kompanive të përfshira në sektorin e karrjerave (guroreve) (të gjitha kompani në prodhim)<sup>34</sup>.

### 2.2.2. Të ardhurat e vjela nga shteti (benefit streams)

Grupi i punës ALBEITI ka vendosur që ky raport EITI të marrë parasysht 3 lloje taksash të veçanta për sektorin minerar ashtu siç përcaktohen në ligjin minerar shqiptar<sup>35</sup>, si dhe tatim fitimin e kompanisë..

Me synim përfshirjen e plotë të kompanive, grupi i punës ALBEITI ka vendosur që: "të ardhura të tjera të rëndësishme / pagesa që kalojnë për shtetin" (me një kufi të caktuar pagese (*materiality threshold*) në 50 mijë USD [5 milionë lek]<sup>36</sup> në vit për kompani) dhe "të ardhurat e tjera të rëndësishme / pagesa për autoritetet vendore (me një prag-kufi të caktuar pagese (*materiality threshold*) në 5 mijë USD [500 mijë Lek]<sup>37</sup> në vit për kompani), duhet të deklarohen gjithashtu nga agjencitë shtetërore dhe kompanitë nxjerrëse.

6 llojet e të ardhurave të mbledhura nga shteti, të përzgjedhura nga sektori minerar për raportin EITI 2010, mund të ilustrohen si më poshtë vijon<sup>38</sup>:



Të ardhurat e mbledhura nga shteti për sektorin minerar të shqyrtuara në raportin EITI 2010

<sup>31</sup> Lista e plotë e kompanive të sektorit minerar të përzgjedhura për raportin EITI 2010 gjendet në shtojcën nr. 3

<sup>32</sup> Qarkullimi vjetor = prodhimi vjetor X cmimi i mineralit

<sup>33</sup> Qarkullimi valutor përdoret si përfaqësim i kontributit fiskal të një kompanie; kjo duket mëse e mjaftueshme në kontekstin e Shqipërisë, ku fitueshmëria e kompanive është relativisht uniforme për shkak të kushteve të ngjashme të nxjerrjes

<sup>34</sup> Lista e plotë e kompanive të sektorit minerar të përzgjedhura për raportin EITI 2010 ndodhet në shtojcën nr. 3

<sup>35</sup> Ligji minerar shqiptar nr. 10304, 15 korrik 2010

<sup>36</sup> < 0.1% të kontributit fiskal të sektorit nxjerrës të publikuar në raportin EITI 2009

<sup>37</sup> < 0.01% të kontributit fiskal të sektorit nxjerrës të publikuar në raportin EITI 2009

<sup>38</sup> Lista e plotë e burimeve të të ardhurave dhe përshkrimi i tyre mund të gjenden në shtojcën nr. 4

### 2.3. Dokumentet standarde të raportimit të përdorura në raport

Dokumentet standarde të raportimit të përdorura për bërjen publike të të dhënave nga agjencitë shtetërore dhe kompanitë nxjerrëse janë krijuar nga ne duke u nisur nga objektivat e përcaktuara nga grupi i punës ALBEITI për Raportin EITI 2010.

Këto dokumente standarde të raportimit janë diskutuar dhe njëkohësisht miratuar nga grupi i punës ALBEITI. Më pas, këto dokumente u janë shpërndarë agjencive shtetërore dhe autoriteteve lokale (vendore) direkt nga ne për të bërë deklaratimet në emër të shtetit shqiptar si dhe 69 kompanive nxjerrëse të përfshira në raportin EITI.

Në përputhje me rekomandimet e Source Book EITI dhe me kërkesat e Rregullores së re EITI si dhe në përputhje me praktikën më të mira të EITI, udhëzimet për plotësimin e dokumenteve standarde të raportimit e vinin theksin tek nevojat për:

- (i) Zbardhjen e të dhënave në kesh (cash), në mënyrë që të rakordohen shumatat e marra, apo të paguara në vitin 2010 dhe jo shumatat e pritshme për pagesë për atë periudhë kohore;
- (ii) Një raportim zë për zë (jo në total) të ndara sipas datave për çdo të ardhur të marrë dhe pagesë të kryer, në mënyrë që të lehtësohet identifikimi i mospërputhjeve të mundshme mes deklaratave;
- (iii) Një deklaratim i të dhënave sipas monedhës që është kryer transaksioni, duke reduktuar në këtë mënyrë rrezikun e mospërputhjeve për shkak të rregullimit të kursit të këmbimit;
- (iv) Dorëzimin e dokumentit të nënshkruar nga çdo palë deklaruese, kjo e nënshkruar nga përfaqësuesi më i lartë ligjor në mbështetje të deklaratave të EITI, ku konfirmohet besueshmëria dhe saktësia e të dhënave të publikuara;
- (v) Dorëzimi i një dokumenti konfirmues i nënshkruar nga një auditor i jashtëm për kontribuesit kryesor më potencialë me të ardhura ndaj shtetit (d.m.th kompanitë e naftës dhe të gazit si dhe kompanitë minerare të mëdha me aktivitet prodhimi). Një dokument i tillë i vërtetuar dëshmon besueshmërinë dhe gjithëpërfshirjen e të dhënave të publikuara. Kjo kërkesë nuk është detyruese për kompanitë e mëdha minerare me aktivitet në fushën e eksplorimit (kërkim-zbulimit).

Ne u kemi paraqitur dokumentet standarde të raportimit dhe udhëzimet mbështetëse për plotësimin e tyre përfaqësuesve të agjencive shtetërore si dhe kompanive nxjerrëse gjatë fazës përgatitore të punës sonë të zhvilluar në Tiranë në muajin prill 2012.

### 3. Natyra dhe shtrirja e punës sonë si administrator i pavarur

Kemi pasur si detyrë mbledhjen, rakordimin (identifikimin dhe zgjidhjen e mospërputhjeve kryesore) si dhe përpilimin e listës së mbledhjes së taksave të deklaruara nga shteti shqiptar si dhe të pagesave të taksave të deklaruara nga kompanitë nxjerrëse sipas objektivit të parashtruar në raportin EITI 2010 të përshkruar më sipër.

Dokumentet standarde të raportimit të përdorura për këtë proces janë plotësuar nën përgjegjësinë e përfaqësuesve të agjencive shtetërore dhe të kompanive nxjerrëse, të cilët na kanë dërguar direkt deklaratat e tyre.

Kemi hyrë në fazën kur mund të paraqesim në mënyrë të konsoliduar për çdo burim të ardhurash në përputhje me objektivin e raportit EITI 2010, shumat e deklaruara të mbledhura nga shteti dhe të deklaruara si të paguara kompanitë nxjerrëse gjatë vitit 2010.

Kemi rakorduar të gjitha të ardhurat dhe pagesat e deklaruara jo në total, por zë për zë. Nuk jemi të autorizuar të shpjegojmë mospërputhjet e krijuara si rezultat i procesit të rakordimit. Puna jonë si administrator i pavarur nuk është të auditojmë apo të vlerësojmë pagesat fiskale të bëra nga sektorët minerarë, apo sektorët e naftës dhe të gazit. Auditimi apo verifikimi i të dhënave që na janë ofruar nuk mund të jetë pjesë e mandatit tonë: prandaj, ne nuk mund të publikojmë gabimet, aktet e paligjshme ose parregullsi të tjera.

Përcaktimet e burimit të të ardhurave të mbledhura nga shteti të përzgjedhura në përputhje me Raportin EITI 2010 janë diskutuar me ne; këto përkufizime janë formuluar nga grupi i punës ALBEITI sipas përgjegjësive të tyre, në përputhje me ligjin për naftën, ligjin minerar dhe atë tatimor. Ne kemi shqyrtuar gjithëpërfshirjen e burimeve të të ardhurave të përfshira sipas objektivave të këtij Raporti.

Ne gjithashtu kemi diskutuar edhe listën e kompanive nxjerrëse të përzgjedhura për përfshirje në raportin EITI 2010, të përcaktuara nga grupi i punës ALBEITI, duke vepruar nën përgjegjësinë e tyre.

Si administrator i pavarur ne kemi kryer aktivitetet e mëposhtme:

- (i) Jemi kujdesur që përkufizimet lidhur me burimet e të ardhurave, të përzgjedhura për Raportin EITI 2010, të jenë në përputhje me përkufizimet e përshkruara sipas rregullave të reja EITI, apo me librin e burimit (Source Book) EITI dhe me përkufizimet e njohura gjerësisht nga kompanitë ndërkombëtare të minierave, naftës dhe gazit (analiza e përputhshmërisë);
- (ii) Kemi treguar kujdes që përkufizimet, lidhur me burimet e të ardhurave të perceptoheshin dhe kuptoheshin drejtë nga ana e përfaqësuesve të agjencive shtetërore dhe e kompanive nxjerrëse (një kuptim sa më i qartë i objektivit të raportit);
- (iii) Kemi mbledhur (nga dorëzimi i dokumenteve kryesorë dhe dokumenteve të tjerë mbështetës) dokumentet standarde të raportimit nga agjencitë shtetërore, që kanë publikuar të ardhurat, e ndara zë për zë, të mbledhura nga kompanitë nxjerrëse për vitin 2010. Këto deklaratat janë paraqitur në përputhje me objektivin e këtij raporti EITI;
- (iv) Kemi mbledhur dokumentet standarde të raportimit nga kompanitë nxjerrëse, që publikuan pagesat e bëra zë për zë për shtetin shqiptar në vitin 2010. Këto deklaratat janë paraqitur në përputhje me objektivin e këtij raporti EITI;
- (v) Kemi rakorduar të dhënat e siguruar nga agjencitë shtetërore dhe nga kompanitë nxjerrëse; Kemi zgjidhur mospërputhjet kryesore të identifikuar përmes procesit të rakordimit, kjo në koordinim me sekretariatit ALBEITI, agjencitë shtetërore dhe kompanitë nxjerrëse. Këto mospërputhje lindën kryesisht për shkak të paraqitjes mbi baza të pagesave te pritshme ( accrual basis) dhe për shkak të disa pasaktësive në raportim;
- (vi) Kemi përpiluar shifrat përfundimtare dhe kemi paraqitur për sektorët e naftës, gazit dhe sektorin minerar rakordimin e të dhënave të deklaruara nga shteti shqiptar dhe nga kompanitë nxjerrëse për vitin 2010, kjo mbi bazë të konsoliduar, për çdo lëvizje të ardhurash për këtë raport EITI.

## 4. Rakordimi përfundimtar i të dhënave për sektorët e naftës, gazit dhe atë minerar

### 4.1. Sektori i naftës dhe i gazit

Rakordimi i të dhënave për sektorin e naftës dhe të gazit, të paraqitur më poshtë, bazohet në deklaratimet e marra nga 8 kompanitë e naftës dhe të gazit, pasi ato kanë përcjellë deklaratat e plotësuara EITI<sup>39</sup>. Këto shifra të agreguara na mundësojnë të kuptojmë llojet kryesore të taksave të paguara nga sektori i naftës dhe i gazit në vitin 2010.

(USD)	2010				
	Të dhënat e deklaruara			Δ Kompanitë - Shtet	Δ Kompanitë - Albpetrol
	Kompanitë	Albpetrol (kompanitë)	Shtet		
1. Bonuset e nënshkrimit	400 000		400 000	-	
2. Renta minerare (nga kompanitë private)	18 499 298		18 801 781	(302 483)	
2. Renta minerare (nga Albpetrol)		7 655 487	8 805 469	(1 149 982)	
3. Pjesa nga ndarja e prodhimit që i shkon Kompanisë Kombëtare të Naftës	24 474 090	24 463 090			11 000
4. Tatimi mbi fitimin (nga kompanitë private)	-		-	-	
4. Tatimi mbi fitimin (nga Albpetrol)		2 644 811	2 415 480	229 331	
5. Dividentët		-	-	-	
6. Pagesa të tjera të rëndësishme që i bëhen shtetit (nga kompanitë private)	100 000		100 000	-	
6. Pagesa të tjera të rëndësishme që i bëhen shtetit (nga Albpetrol)		1 849 455	1 860 013	(10 558)	
7. Pagesa të tjera tek pushteti vendor (nga kompanitë private)	-		-	-	
7. Pagesa të tjera tek pushteti vendor (nga Albpetrol)		-	-	-	
<b>Total (USD)</b>	<b>43 473 388</b>		<b>32 382 743</b>	<b>(1 233 692)</b>	<b>11 000</b>

#### Rakordimi i të dhënave për sektorin e naftës dhe të gazit (2010)

Kompanitë private të naftës dhe gazit kanë deklaruar 43.5 milion USD (4.4 miliard leke) pagesa të bëra : Shtetit Shqiptar (19 milion USD ose 1.9 miliard lekë) dhe Albpetrol-it (24.5 milion USD, or 2.5 miliard Lekë)

Deri më datën e publikimit të këtij raporti, vetëm kompania Sky Petroleum nuk ka dorëzuar deklaratat EITI. Arbitrazhi i vazhduar midis kompanisë dhe shtetit shqiptar për dy marrëveshje për ndarjen e prodhimit (PSA), të nënshkruara në muajin qershor 2010<sup>40</sup>, mund të shpjegojë këtë mungesë deklarimi nga ana e tyre. Kontributi i kufizuar fiskal i kompanive me aktivitet në eksplorim dhe perspektiva e vogël që Sky Petroleum të ketë kryer bonuset e nënshkrimit në vitin 2010 na lejojnë të besojmë se kontributi efektiv fiskal i kësaj kompanie në vitin 2010 ndoshta nuk ishte i madh. Ky përfundim i joni konfirmohet dhe nga deklaratat EITI të paraqitura nga shteti shqiptar lidhur me Sky Petroleum, e cila nuk ka deklaruar asnjë shifër. Për sa më lartë, mund të nxjerrim përfundimin se kjo mungesë deklarimi nga Sky Petroleum nuk ndikon në paraqitjen e kontributit fiskal të sektorit të naftës dhe gazit me të ardhurat e tyre për shtetin në vitin 2010.

<sup>39</sup> Nga 9 kompani të naftës dhe të gazit të përfshira në raportin Albeiti 2010

<sup>40</sup> Nje PSA mbulon blloqet 4 dhe 5 dhe një tjetër mbulon bllokun ne det të hapur ne Dumre, sic përfaqësohet në *Raportin GEPS Shqipëria*, HIS, janar 2012

Në përfundim, ashtu si edhe për vitin 2009, vërejmë se kontributi i përgjithshëm fiskal i sektorit të naftës dhe të gazit mbetet marginal në lidhje me të ardhurat e përgjithshme fiskale të mbledhura nga shteti shqiptar në vitin 2010<sup>41</sup> (me rreth 1%).



Kontributi fiskal në total nga sektori i naftës dhe i gazit krahasuar me të ardhurat e përgjithshme të shtetit shqiptar (2010)

#### 4.2. Sektori minerar

Rakordimi i të dhënave për sektorin minerar, të paraqitur më poshtë, është bazuar në deklaratimet e marra nga 54 kompani minerare që kanë dërguar deklaratat e plota EITI<sup>42</sup>. Këto shifra të agreguara na lejojnë të kuptojmë rentën minerare që paraqitet si pagesa kryesore fiskale e bërë për shtetin shqiptar nga kompanitë minerare në vitin 2010 (46%), pasuar nga tatim mbi fitimin (36%) dhe taksa e sipërfaqes (5%).

(Leks)	2010		
	Të dhënat e deklaruara		
	Kompanitë	Shtet	Variacion
1. Bonuset e nënshkrimit	1 982 902	2 982 792	(999 890)
2. Taksat për sipërfaqen	29 698 393	22 201 355	7 497 038
3. Renta minerare	282 413 274	290 739 932	(8 326 658)
4. Tatimi mbi fitimin	218 171 239	215 084 788	3 086 451
5. Pagesa te tjera te rëndesishme qe i bëhen shtetit	73 694 676	73 694 676	-
6. Pagesa te tjera tek pushteti vendor	6 893 906	5 640 640	1 253 266
<b>Total (Leks)</b>	<b>612 854 390</b>	<b>610 344 183</b>	<b>2 510 207</b>

Rakordimi i të dhënave për sektorin minerar (2010)

Kompanitë e Minerave kanë deklaruar 613 milion Lekë (6.2 milion USD) pagesa të bëra Shtetit Shqiptar.

Deri më datën e publikimit të këtij raporti, kompanitë e mëposhtme nuk kanë dorëzuar deklaratat EITI:

- Kompania Cougar Mining (sektori minerar i madh - zbulimi);
- Bytyci, Marei, Shkembia dhe Tadri (sektori minerar i mesëm dhe i vogël);
- Dks Group (sektori gëlqeror).


Kompania Cougar Mining ishte përfshirë në aktivitete zbulimi në vitin 2010. Kjo kompani, me sa duket, është larguar nga Shqipëria në vitin 2011. Kontributi i kufizuar fiskal i kompanive me aktivitet në zbulimi dhe perspektiva e vogël që kompania minerare Cougar të ketë kryer bonuset e nënshkrimit në vitin 2010 na lejojnë të besojmë se kontributi efektiv fiskal i kësaj kompanie në vitin 2010 ndoshta nuk ishte i madh. Përmasat e kufizuara të 5 kompanive të tjera, që nuk kanë dorëzuar deklaratat EITI na çojnë në të njëjtin konkluzion. Përveç kësaj, deklaratat marginale të paraqitura nga shteti shqiptar për këto 6 kompani (17 milionë lek në total), pra më pak se 3% e shumës totale të deklaruar si të mbledhur nga shteti shqiptar nga sektori minerar në

<sup>41</sup> Kuptojmë se të ardhurat fiskale në total për shtetin shqiptar arritën në 2.9 miliardë USD (288.8 miliardë Lek) në vitin 2010, siç gjendet në *Shqipëria: Artikulli IV konsultime 2011 – Staff Report*, FMN, tetor 2011

<sup>42</sup> Nga 60 kompani minerare të përfshira në objektivat e raportit Albeiti 2010: 7 për sektorin e madh minerar, 38 për sektorin e mesëm dhe të vogël minerar dhe 15 për sektorin guror.


2010, na bëjnë të arrijmë në përfundimin se kjo mungesë e deklarimeve nuk ndikon/nuk ka impakt të dukshëm në paraqitjen e kontributit fiskal të sektorit të minierave me të ardhura për shtetin shqiptar në vitin 2010.

Vërejmë se ky kontribut shumë i vogël fiskal ka ardhur nga mbështetja në mënyrë pothuajse e barabartë si nga ana e kompanive të mëdha, ashtu dha nga kompanitë minerare të mesme dhe të vogla (përkatësisht 40% dhe 41% e taksave të mbledhura nga sektori minerar). Në kushtet e pragut-kufirit të pagesave (*materiality*), kjo do të thotë se kontributi fiskal i 6 kompanive të mëdha minerare që kanë paraqitur deklaratat EITI<sup>43</sup> -dy nga të cilat vërtetohen edhe nga auditorët e tyre të jashtëm - është pothuajse po aq i rëndësishëm sa dhe kontributi fiskal i 34 kompanive minerare të mesme dhe të vogla që morën pjesë në procesin EITI<sup>44</sup>.



Kontributi fiskal I kompanive të ndryshme që përbëjnë sektorin minerar (2010)

Në përfundim, vërejmë se kontributi i përgjithshëm fiskal i sektorit të minierave ka mbetur shumë i vogël kundrejt të ardhurave të përgjithshme fiskale të mbledhura nga shteti shqiptar në vitin 2010<sup>45</sup> (diku nën 0,2%).



Kontributi total fiskal i sektorit minerar krahasuar me të ardhurat e përgjithshme fiskale të shtetit shqiptar (2010).

<sup>43</sup> 2.4 milionë USD (246.3 milionë lek), siç deklarohet nga shteti shqiptar

<sup>44</sup> 2.5 milionë USD (248.6 milionë lek), siç deklarohet nga shteti shqiptar

<sup>45</sup> Kuptojmë se të ardhurat fiskale në total për shtetin shqiptar arritën në 2.9 miliardë USD (288.8 miliardë Lek) në vitin 2010, siç gjendet në *Shqipëria: Artikulli IV konsultime 2011 – Staff Report, FMN, tetor 2011*



#### 4.3. Konkluzionet kryesore

Vëzhgimet e mëposhtme bazohen në informacionin që na është vënë në dispozicion nga grupi i punës ALBEITI, shteti shqiptar dhe kompanitë nxjerrëse:

- (i) Përkufizimet e lëvizjes së të ardhurave të përzgjedhura nga grupi punës ALBEITI për Raportin EITI 2010 janë në përputhje me përcaktimet e përshkruara në rregulloren e re EITI, në Source Book të EITI dhe me standardet e njohura gjerësisht nga industritë ndërkombëtare të naftës, gazit dhe sektorit minerar;
- (ii) Përkufizimet e lëvizjes së të ardhurave diskutuar bashkërisht me përfaqësuesit e agjencive shtetërore dhe të kompanive nxjerrëse;
- (iii) Deklaratat e paraqitura nga shteti shqiptar dhe nga kompanitë nxjerrëse janë dorëzuar në përputhje me këto përkufizime;
- (iv) Pjesëmarrja e kompanive kryesore të naftës, gazit dhe të sektorit minerar në procesin e deklarimit EITI, së bashku me deklaratat e "çdo pagese tjetër të rëndësishëm për shtetin" na lejojnë të arrijmë në përfundimin se ky raport EITI mbulon kontributet më të rëndësishme fiskale të sektorit nxjerrës ndaj shtetit shqiptar;
- (v) Deklaratat e kompanive të naftës dhe të gazit dhe të kompanive të mëdha minerare me aktivitet në prodhim janë vërtetuar nga auditorët e tyre të jashtëm duke siguruar besueshmërinë dhe gjithëpërfshirjen e të dhënave të publikuara;
- (vi) Rakordimi i ndarë zë për zë (i paagreguar) i deklaratave të paraqitura nga shteti shqiptar dhe nga kompanitë e naftës, gazit dhe të minierave nuk nxorri në dukje ndonjë mospërputhje të konsiderueshme;
- (vii) Kompanite private të naftës dhe gazit kane deklaruar 43.5 milion USD (4.4 miliard leke) pagesa të bëra : Shtetit Shqiptar (19 milion USD ose 1.9 miliard lekë) dhe Albpetrol-it (24.5 milion USD, or 2.5 miliard Lekë);
- (viii) Kompanitë e Minierave kanë deklaruar 613 milion Lekë (6.2 milion USD) pagesa të bëra Shtetit Shqiptar.

## 5. Komentet dhe rekomandimet kryesore

### 5.1. Përkufizimi mbi objektivat e përdorur

Në përgjigje të konkluzioneve të Komitetit të vlefshmërisë EITI, grupi i punës ALBEITI ka vendosur të zgjerojë objektivat e Raportit të dytë EITI duke përzgjedhur edhe një numër shumë të madh kompanish minerare të mesme e të vogla si dhe sektorët e karrjerave (gurorëve)<sup>46</sup>. Përfshirja e këtyre kompanive deklaruese, të vogla por edhe të shpërndara në territor, rezultojë një punë tepër sfiduese dhe jo e përshtatur me kërkesat dhe qëllimet e procesit EITI.

Aspekti kohor dhe logjistika e nevojshme për të mbledhur të dhënat e besueshme dhe të plota nga më shumë se 80 kompani deklaruese (62 kompani nxjerrëse, 4 agjenci shtetërore, 15 autoritete lokale), ka qenë në të vërtetë e madhe. Pavarësisht pjesëmarrjes së tyre, paraqitja e tyre sipas objektivave të këtij raporti ka rezultuar jobindëse në aspektin e pragut-kufirit të pagesës (*materiality*), siç tregohet në § 4. Me të vërtetë, taksat e mbledhura nga 3 kompanitë prodhuese të naftës dhe të gazit janë 5 herë më shumë se taksat e mbledhura nga 59 kompanitë nxjerrëse që kanë dorëzuar deklaratat EITI.

Me synim kapërcimin e kësaj vështirësie, pa kompromentuar rëndësinë dhe mbulimin e procesit EITI, ne i rekomandojmë grupit të punës ALBEITI që të përshtatë objektivat e raporteve në të ardhmen me realitetin dhe qëllimet e procesit EITI dhe të përqendrojë vëmendjen e saj tek tatimpaguesit më të mëdhenj të kompanive nxjerrëse, d.m.th tek kompanitë e naftës dhe të gazit si dhe tek kompanitë e mëdha minerare

Nëse do të merret parasysh përfshirja e kompanive të mesme dhe të vogla dhe e sektorit të karrjerave (gurorëve), atëherë sugjerojmë që të:

- (i) Të rritet më shumë pragu-kufiri i pagesave (*materiality*) për raportet e ardhshme EITI;
- (ii) Duhet të shihet mundësia e kalimit tek deklaratat e njëanshme për operatorët më të vegjël. Një procedurë e tillë është plotësisht në përputhje me rregulloren e re EITI47. Ajo trajton në mënyrë pragmatike vështirësitë dhe çështjet e pragut të pagesave të ngritura më sipër, pa penguar nxjerrjen e duhur të kontributit fiskal të këtyre aktorëve të vegjël dhe të shumtë kundrejt të ardhurave shtetërore.

### 5.2. Rritja e aksesit ndaj të dhënave

Përkundër udhëzimeve të qarta dhe të detajuara, lidhur me plotësimin e deklaratave, një numër i konsiderueshëm deklaratash nga agjencitë shtetërore, edhe pse më pak nga kompanitë nxjerrëse, u plotësuan mbi bazë të pagesave që kompanitë duhet të bënin në baza vjetore dhe jo në baza efektive (*accrual basis*). Për këtë arsye, është kryer një punë shtesë dhe për pasojë një numër i konsiderueshëm deklaratash të rishikuara janë dashur për të reduktuar mospërputhjet kryesore. Kjo nxori në dritë vështirësitë e disa agjencive shtetërore për të aksesuar të dhënat e besueshme të përcaktuara në bazë të pagesave efektive (*cash basis*). Kjo e vë theksin tek nevoja për të forcuar procedurat e informacionit dhe monitorimit të shtetit lidhur me taksat e mbledhura në mënyrë efektive veçanërisht nga kompanitë nxjerrëse, por jo ekskluzivisht në kontekstin e Raportit EITI.

Caktimi formal i një pike kontakti EITI për çdo agjenci përkatëse shtetërore (AKBN, METE, Drejtorja e Përgjithshme e Tatimeve, Drejtorja e Përgjithshme e Doganave), si dhe brenda vetë kompanive të mëdha nxjerrëse (naftë, gaz dhe sektori mineral i madh) do të ndihmojnë në kapërcimin e kësaj vështirësie. Organizimi i një seminari EITI me pjesëmarrjen e pikave të kontaktit duhet të propozohet para daljes së raportit të ardhshëm të EITI.

<sup>46</sup> Objektivi i raportit ALBEITI 2010 përfshin 53 kompani të mesme dhe të vogla minerare dhe sektorin guror, kundrejt 31 të përfshira në raportin EITI 2009

<sup>47</sup> Kriteret nr 11. (b) të rregullave EITI tregojnë qartë: "një ent duhet të përjashtohet nga raportimi vetëm nëse tregon një shkallë më të lartë sigurie se shumatat që raporton në cdo rast do të jenë jomateriale", rregullat Eiti, 2011, Sekretariati nderkombëtar Eiti, Oslo, 16 shkurt 2011

### 5.3. Shqyrtimi i deklaratave nga autoritet vendore

Grupi i punës ALBEITI ka zgjedhur që të përfshijë "të ardhura të tjera të rëndësishme / pagesa për autoritetet vendore", si një ndër objektivat e tjerë të lëvizjes së të ardhurave në këtë Raport, me një prag-kufi kontributi pagese prej 5 mijë USD (500 000 Lek) në vit për kompani. Nëse ky vendim dukej i nevojshëm në lidhje me zgjerimin e objektivave të raportit EITI, kjo nuk ka rezultuar bindëse në drejtim të kryerjes se pagesës në nivel pragu (*materiality*)<sup>48</sup>.

Në mënyrë që të kufizohet koha e kërkuar në mbledhjen e të ardhurave jo-materiale, rekomandojmë që:

- (i) Lista e 15 rretheve të përfshira për këtë raport të ri-shqyrtohet edhe njëherë, në mënyrë që të përfshijë të gjitha rrethet që mbledhin në mënyrë efektive kontribute fiskale nga kompanitë nxjerrëse (si qarkun e Fierit ku operon Albpetrol). Komunat dhe bashkitë, të cilat mbledhin kontribute fiskale nga kompanitë nxjerrëse, gjithashtu duhet të përfshihen në raportet e ardhshme;
- (ii) Grupi i punës ALBEITI duhet të marrë parasysh vetëm kontributin fiskal të kompanive nxjerrëse tek autoritetet lokale përmes deklaratave të njëanshme.

### 5.4. Evoluimi i objektivave të raporteve të ardhshme EITI

Ne e kuptojmë se disa kompani janë në negociata me shtetin shqiptar kryesisht për blloqet në det 2,3,4 të Adriatikut dhe Kepi I Rodonit në Veri<sup>49</sup>:

- Pelagian Oil (Adriatic Oil qysh në muajin shkurt 2012);
- Repsol;
- Gas Plus Italiana;
- Pathfinder Hydrocarbon Ventures.

Këto negociata mund të kenë çuar në pagesën e bonuseve të nënshkrimit; prandaj ne rekomandojmë që këto kompani të jenë objekt i raporteve të ardhshme EITI.

Për më tepër, deklaratat e "të ardhurave të tjera të rëndësishme/ pagesat ndaj shtetit" kanë nxjerrë në dritë deklaratat tatimore të dividendëve. Këto pagesa tatimore për vitin 2010 janë marrë parasysh në këtë raport EITI, por ne rekomandojmë që të merret parasysh ky burim të ardhurash në raportet e ardhshme EITI.

Së fundmi, rekomandojmë që grupi i punës ALBEITI të kërkojë që deklaratat nga të gjitha kompanitë e mëdha minerare (me aktivitet në prodhim dhe në zbulim) të vërtetohen nga auditorët e tyre të jashtëm, në mënyrë që të forcohet më tej besueshmëria dhe gjithëpërfshirja e raporteve të EITI në Shqipëri.

<sup>48</sup> Siç u paraqit në § 4, vetëm sektori minerar ka bërë publike të dhënat për këtë kategori. Shifrat e përpiluara zor se përfaqësojnë 1 % të kontributit total fiskal të sektorit minerar për shtetin shqiptar në vitin 2010.

<sup>49</sup> *Raporti Shqipëria GEPS*, IHS, janar 2012

# Shtojcat

- Shtojca 1:** Lista e kompanive nga sektori i naftës dhe gazit të përzgjedhur për përfshirje në raportin EITI 2010
- Shtojca 2:** Lista dhe përkufizimet e burimeve të të ardhurave nga sektori i naftës dhe gazit të përzgjedhura për përfshirje në raportin EITI 2010
- Shtojca 3:** Lista e kompanive nga sektori mineral të përzgjedhura për raportin EITI 2010
- Shtojca 4:** Lista dhe përkufizimet e burimeve të të ardhura nga sektori mineral për raportin EITI 2010
- Shtojca 5:** Lista e Agjencive shteterore dhe autoriteteve vendore raportuese)

## Shtojca 1: Lista e kompanive nga sektori i naftës dhe gazit të përzgjedhur për përfshirje në raportin EITI 2010

**Kompanite Private ne prodhim (2)**

- Bankers Petroleum
- Stream Oil & Gas

**Kompani Kombetare (ne prodhim)**

- Albpetrol

**Kompanite Private ne zbulim (6)**

- IEC Visoka
- Capricorn Albania (degë e Cairn)
- Island International Exploration (degë e San Leon Energy plc)
- Manas Adriatic (degë e DWM e më pas Petromanas Energy Inc.)
- Sherwood International Petroleum Ltd. (degë e Bankers Petroleum)
- Sky Petroleum

## Shtojca 2: Lista dhe përkufizimet e burimeve të të ardhurave nga sektori I naftës dhe gazit të përzgjedhura për përfshirje në raportin EITI 2010

### 1. Lista e burimeve të të ardhura

Nga Albpetrol (5)	Nga kompanitë në prodhim dhe në eksplorimin (6)
- Renta minerare	- Bonuset e nënshkrimit
- Tatimi mbi fitimin	- Renta minerare
- Dividentët	- Pjesa nga ndarja e prodhimit që i shkon Kompanisë Kombëtare të Naftës
- Pagesa të tjera të rëndësishme që i bëhen shtetit	- Tatimi mbi fitimin
- Pagesa të tjera tek pushteti vendor	- Pagesa të tjera të rëndësishme që i bëhen shtetit
	- Pagesa të tjera tek pushteti vendor

### 2. Përkufizimi i burimeve të të ardhurave

#### Bonuset e nënshkrimit

Bonuset e nënshkrimit përcaktohen (ne baze të negociatave Kontraktuale) kur jepen leja e zbulimit apo leja e prodhimit (shfrytëzimit), ne kuader të kushteve dhe afateve të veçanta kontraktuale.

#### Renta minerare

Renta minerare zbatohet për vlerën e tatueshme (ose vlerën fiskale) të shitjeve. Rentën për eksportin e produkteve minerare e mbledh Drejtoria e Përgjithshme e Doganave, ndërsa rentën për shitjen e produkteve minerare brenda vendit e mbledh Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve.

#### Pjesa nga ndarja e prodhimit që i shkon Kompanisë Kombëtare të Naftës

Albpetrol-it, Kompanisë Kombëtare të Naftës, i takon të marre pjesë nga ndarja e prodhimit. Kjo pjesë e ndare përcaktohet sipas një kontrakte, ne baze të prodhimit të vlerësuar (prodhimit paraekzistues) dhe prodhimit të shtuar (prodhimit që përfitohet nga investimi i kontraktuesit). Pagesa për pjesën nga ndarja e prodhimit, që i shkon Albpetrolit mund të bëhet me para në dore (cash) ose në natyrë (fuçi naftë).

#### Dividentët (Për Albpetrol vetëm)

Dividentët korrespondojnë me përfitimin e Kompanisë Kombëtare të Naftës i cili rishpërndahet tek Shteti si aksioner i vetëm. Niveli i Dividentit përcaktohet nga Bordi i kompanisë.

#### Tatimi mbi fitimin

Tatim-fitimi i shoqërive përllogaritet ne baze të fitimit të tatueshëm të kompanisë. Tatim-fitimi mbledhet nga Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve.

#### Pagesa të tjera të rëndësishme që i bëhen shtetit

Për të siguruar përfshirje të plote kompanitë duhet të deklarojnë çdo pagesë të bërë tek shteti që ato e konsiderojnë të rëndësishme (> 50,000 USD në vit).

#### Pagesa të tjera tek pushteti vendor

Për të siguruar përfshirje të plote dhe identifikimin e flukseve të rëndësishme që mund të mungojnë, kompanitë duhet të deklarojnë të gjitha pagesat pranë pushtetit vendor rreth, (bashki, komuna) që kalojnë shumën prej (> 5,000 USD në vit).

## Shtojca 3: Lista e kompanive nga sektori minerar të përzgjedhura për raportin EITI 2010

Kompanite e mëdha në sektorin minerar në prodhim (2)	Kompanite e mëdha në sektorin minerar në zbulim (5)
<ul style="list-style-type: none"> <li>- Albanian Chrome shpk (Krom)</li> <li>- BerAlba shpk (Baker)</li> </ul>	<ul style="list-style-type: none"> <li>- Empire Mining (Krom)</li> <li>- Jab Resources (Krom)</li> <li>- Balkan Resources (Baker)</li> <li>- Cougar Mining (Baker)</li> <li>- Tirez Exploration (Baker)</li> <li>- Balkan Resources (Nikel)</li> </ul>
<b>Sektori minerar i mesëm dhe i vogël (38)</b>	
<ul style="list-style-type: none"> <li>- Afrimi – k (Krom)</li> <li>- Alb-Canaj (Krom)</li> <li>- Algej shpk (Krom)</li> <li>- Ateani shpk (Krom)</li> <li>- Bytyci (Krom)</li> <li>- Egi-K (Krom)</li> <li>- Elidon – 06 (Krom)</li> <li>- Ernisi shpk (Krom)</li> <li>- Fabrika e Pasurimit te Kromit (Krom)</li> <li>- Florida shpk (Krom)</li> <li>- Gentari (Krom)</li> <li>- Gjoni shpk (Krom)</li> <li>- Herbi (Krom)</li> <li>- Info Metal Plast al shpk (Krom)</li> <li>- Klervibris shpk (Krom)</li> <li>- Klosi shpk (Krom)</li> <li>- Koka shpk (Krom)</li> <li>- Aren 2003 (Nikel)</li> <li>- Alb xhoi (Nikel)</li> </ul>	<ul style="list-style-type: none"> <li>- Koxheri shpk (Krom)</li> <li>- Krasta shpk (Krom)</li> <li>- Kromex Import Export (Krom)</li> <li>- Lahaze (Krom)</li> <li>- Lamnica shpk (Krom)</li> <li>- Leshnica (Krom)</li> <li>- Marei shpk (Krom)</li> <li>- Mineral – Invest shpk (Krom)</li> <li>- Miniera e kromit katjel (Krom)</li> <li>- Neli (Krom)</li> <li>- Ral shpk (Krom)</li> <li>- Runja (Krom)</li> <li>- Shkalla shpk (Krom)</li> <li>- Shkëmbi shpk (Krom)</li> <li>- Tadri shpk (Krom)</li> <li>- Tollja (Krom)</li> <li>- Vellazeria shpk (Krom)</li> <li>- Ylberi shpk (Krom)</li> <li>- Selenice Bitumi sha (Bitum natyror)</li> </ul>
<b>Sektorin e karrjerave (guroreve) (15)</b>	
<ul style="list-style-type: none"> <li>- Alb Tifbau (Gelqeror)</li> <li>- Antea cement (Gelqeror)</li> <li>- Babasi coo shpk (Gelqeror)</li> <li>- F. Kruja cement factory (Gelqeror, Argjile)</li> <li>- Makaresh shpk (Gelqeror)</li> <li>- Salillari shpk (Gelqeror)</li> <li>- Shkodra inert (Gelqeror)</li> <li>- Stone Production (Gelqeror)</li> <li>- Vellezerit Llupo shpk (Gelqeror)</li> </ul>	<ul style="list-style-type: none"> <li>- B &amp; b Stone (Ranor silicor)</li> <li>- Dks Group shpk (Ranor silicor)</li> <li>- Albitoil shpk (Rere bituminoze)</li> <li>- Prodhime Karbonike sha (Skorje ferrokromi)</li> <li>- Arsi shpk (Sterile Kromi)</li> <li>- Klervibris shpk (Sterile Kromi)</li> </ul>

## Shtojca 4: Lista dhe përkufizimet e burimeve të të ardhura nga sektori minerar për raportin EITI 2010

### 1. Lista e burimeve të të ardhura

Nga kompanitë në prodhim (6)	Nga kompanitë në zbulim (4)
- Bonuset e nënshkrimit	- Bonuset e nënshkrimit
- Taksat për sipërfaqen	- Taksat për sipërfaqen
- Renta minerare	- Pagesa te tjera te rëndesishme qe i bëhen shtetit
- Tatimi mbi fitimin	- Pagesa te tjera tek pushteti vendor
- Pagesa te tjera te rëndesishme qe i bëhen shtetit	
- Pagesa te tjera tek pushteti vendor	

### 2. Përkufizimi i burimeve të të ardhurave

#### Bonuset e nënshkrimit

Bonuset e nënshkrimit përcaktohen (ne baze te negociatave Kontraktuale) kur jepen leja e zbulimit apo leja e (prodhimit), ne kuader të kushteve dhe afateve të veçanta kontraktuale.

#### Taksat për sipërfaqen

Taksat për sipërfaqen janë tatim qe paguajnë mbajtësit e licencave te zbulimit apo te prodhimit (shfrytezimit) sipërfaqes gjeografike. Taksat për sipërfaqen i mbledh Ministria e Ekonomise, Tregtisë dhe Energjetikes.

#### Renta minerare

Renta minerare zbatohet për vlerën e tatueshme (ose vlerën fiskale) te shitjeve. Rentën per eksportin e produkteve minerare e mbledh Drejtoria e Përgjithshme e Doganave, ndërsa rentën per shitjen e produkteve minerare brenda vendit e mbledh Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve.

#### Tatimi mbi fitimin

Tatim-fitimi i shoqërive përlloraget ne baze te fitimit të tatueshëm te kompanisë. Tatim-fitimi mblidhet nga Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve.

#### Pagesa te tjera te rëndesishme qe i bëhen shtetit

Për te siguruar përfshirje te plote kompanitë duhet të deklarojnë cdo pagese te bere tek shteti qe ato e konsiderojne te rendesishme (> 50,000 USD ne vit).

#### Pagesa te tjera tek pushteti vendor

Për te siguruar përfshirje te plote dhe indentifikimin e flukseve të rëndësishme qe mund te mungojnë, kompanitë duhet te deklarojnë te gjitha pagesat pranë pushtetit vendor rreth, (bashki, komuna) qe kalojnë shumen prej (> 5,000 USD ne vit).



## Shtojca 5: Lista e Agjencive shteterore dhe autoriteteve vendore raportuese

### State agencies

#### Nga sektori i naftës dhe gazit (4)

- Albpetrol, duke deklaruar:
  - Bonuset e nënshkrimit (faza e zbulimit)
  - Pjesa nga ndarja e prodhimit që i shkon Kompanisë Kombëtare të Naftës
  - Pagesa të tjera të rëndësishme që i bëhen shtetit (> 50.000 USD/5 MLeKs)
- AKBN, duke deklaruar:
  - Bonuset e nënshkrimit (faza e eksplorimit)
  - Pagesa të tjera të rëndësishme që i bëhen shtetit (> 50.000 USD/5 MLeKs)
- Drejtoria Përgjithshme e Tatimeve, duke deklaruar:
  - Renta minerare (shitjet e brendshme)
  - Tatimi mbi fitimin
  - Dividentët (Për Albpetrol vetëm)
  - Pagesa të tjera të rëndësishme që i bëhen shtetit (> 50.000 USD/5 MLeKs)
- Drejtoria Përgjithshme e Doganave, duke deklaruar:
  - Renta minerare (shitjet e eksportit)
  - Pagesa të tjera të rëndësishme që i bëhen shtetit (> 50.000 USD/5 MLeKs)

#### Nga sektori minerar (4)

- AKBN, duke deklaruar:
  - Bonuset e nënshkrimit
  - Pagesa të tjera të rëndësishme që i bëhen shtetit (> 50.000 USD/5 MLeKs)
- Drejtoria Përgjithshme e Tatimeve, duke deklaruar:
  - Renta minerare (shitjet e brendshme)
  - Tatimi mbi fitimin
  - Pagesa të tjera të rëndësishme që i bëhen shtetit (> 50.000 USD/5 MLeKs)
- Drejtoria Përgjithshme e Doganave, duke deklaruar:
  - Renta minerare (shitjet e eksportit)
  - Pagesa të tjera të rëndësishme që i bëhen shtetit (> 50.000 USD/5 MLeKs)
- Ministria e Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës-METE), duke deklaruar:
  - Taksat për sipërfaqen
  - Pagesa të tjera të rëndësishme që i bëhen shtetit (> 50.000 USD/5 MLeKs)

### Pushteti vendor

*Nga të gjitha pagesat e bera tek autoritetet vendore "te ardhura të tjera të rëndësishme" janë kërkuar të deklarohen vetëm ato > 5.000 USD/500 mijë leke*

#### Nga sektori i naftës dhe gazit (15)

- Berat
- Bulqize
- Devoll
- Elbasan
- Has: nuk ka deklaram (nuk ka ndikim material)
- Kruje
- Kukes: nuk ka deklaram (nuk ka ndikim material)
- Librazhd
- Mat: nuk ka deklaram (nuk ka ndikim material)
- Pogradec
- Puke
- Shkoder: nuk ka deklaram (nuk ka ndikim material)
- Skrapar
- Tropoje
- Vlore

#### Nga sektori minerar (15)

- Berat
- Bulqize
- Devoll
- Elbasan
- Has: nuk ka deklaram (nuk ka ndikim material)
- Kruje
- Kukes: nuk ka deklaram (nuk ka ndikim material)
- Librazhd
- Mat: nuk ka deklaram (nuk ka ndikim material)
- Pogradec
- Puke
- Shkoder: nuk ka deklaram (nuk ka ndikim material)
- Skrapar
- Tropoje
- Vlore



42 Avenue Montaigne  
75008 Paris - FRANCE

-  
1 Heddon Street  
London W1B1BD - UK

